



REPUBLICA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INOVACIONIT

DEKANI

Nr. 05/4 Prot.

Tiranë më 9 / 3 / 2023

Drejtuar: Prof. Dr. Ethem Ruka
Rektor i Universitetit "Luarasi"

Lënda: Vendimi për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për vitin akademik 2024-2025

I nderuar Rektor,

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, në propozimet e Departamenteve të Informatikes Ekonomike, Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Matematikë Statistikë, Dekanati i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2023, propozon për miratim kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, për vitin akademik 2024-2025.

Gjeni ju lutem bashkangjitur vendimin përkatës.

DEKANI


Prof. Asoc. Dr. Anni DASHO SHARKO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INOVACIONIT

DEKANI

V E N D I M

Nr. 2, Datë 8.3.2023

“Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.7.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, Dekanati i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, i mbledhur në datën 8.3.2023, miratoi propozimin e Departamenteit të Informatikes Ekonomike, Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Matematikë - Statistikës, për kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për vitin akademik 2024-2025,

V E N D O S I :

1. Në programin e studimit “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
 - i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë).
 - ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
 - iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) 80% sipas notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - b) 20% sipas mesatares për lëndën me zgjedhje të maturës shtetërore.Lënda me zgjedhje e maturës shtetërore është si vijon:
 - Gjuhë e Huaj 20%.
 - iv. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Në programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
 - i. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë).
 - ii. Plotësojnë kriterin e notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
 - iii. Renditja e aplikantëve do të kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- c) 80% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
 - d) 20% mesataren për lëndën me zgjedhje të maturës shtetërore.
- Lënda me zgjedhje e maturës shtetërore është si vijon:
- Gjuhë e Huaj 20%.
- iv. Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:

- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë).
- b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë, Bachelor, në: Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Informatikë, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Informatikë Ekonomike Financë Bankë, Informatikë Ekonomike Administrim Biznes, Inxhinieri Financë-Bankë, Kontabilitet, Ekonomiks, Administrim Biznes, Marketing, Menaxhim, etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.
 - i. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.
- c. Zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze, Niveli B1, mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar, sipas përcaktimit të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
 - b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.
- 4. Në programin e studimit “Master Profesional” në “Siguria kibernetike dhe e Informacionit ”** pranohen për t’u regjistruar aplikantët të cilët:
- a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
 - b. Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të studimeve të Ciklit të Parë, “Bachelor”, në të gjitha programet e ofruara në Teknologji Informacioni, Informatikë Ekonomike, Informatikë,





Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Informatikë Ekonomike Financë Bankë, Informatikë Ekonomike Administrim Biznes, Inxhinieri Financë-Bankë, Kontabilitet, Ekonomiks, Administrim Biznes, Marketing, Menaxhim, etj., së bashku me çertifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me to nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë në fushat e mësipërme.


- i. Kanë të drejtën e pranimit vetëm aplikantët nga fushat e mësipërme, njohuritë formuese të të cilëve konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre.

Për shtetasit e huaj kërkohet edhe:

- a. Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit;
- b. Dëshmia e njohjes së gjuhës shqipe e lëshuar nga Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2024-2025.

DEKANI


Prof. Assoc. Dr. Anni DASHO SHARKO

